



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.427/8 prot.

Datë 13.03.2024

**V E N D I M**

**Nr. 278 /2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.03.2024 me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me REF-93394-01-18-2024, me objekt: “Blerje materiale mjekësore”, me fond limit 1,474,160 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Shëndetësore e Specialiteteve nr.1, Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “TRIMED” SHPK, me Nipt. *K51612031J dhe Adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Z. Kadastrale 2105, Nr. Pasurie 95/11, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Shëndetësore e Specialiteteve nr.1, Tiranë.  
*Adresa: Rr. “Vllazën Huta”, Tiranë.*
- Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK, me Nipt. *L81512021D dhe Adresë: Rr. “Don Bosko”, Blloku Nr.1, Shkalla Nr.3, Kati I, Nr.4. Tiranë.*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020  
“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin  
e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit  
Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -  
19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, informacionin e autoritetit kontraktor, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.01.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-93394-01-18-2024, me objekt: “Blerje materiale mjekësore”, me fond limit 1,474,160 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Shëndetësore e Specialiteteve nr.1, Tiranë.

II.2. Në datën 06.02.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton, se në datën 16.02.2024, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike si më poshtë:

1. Aquarius Medical SHPK	me ofertë	1,170,920 Lekë pa TVSh	kualifikuar
2. TRIMED SHPK	“	1.234.295 “	kualifikuar
3. CFO PHARMA SHPK	“	1.465.710 “	kualifikuar

II.4. Në datën 19.02.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim - fituesi paraprak në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK, me numër ankimi elektronik A/2024/3817, datë 21.02.2024, dhe me nr. 427/2024 prot., datë 22.02.2024, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-93394-01-18-2024, me objekt: “Blerje materiale mjekësore” me fond limit 1,474,160 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shëndetësore e Specialiteteve nr.1, Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 427/2 prot., datë 23.02.2024 lidhur me pretendimet e ankimuesit “TRIMED” SHPK.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 193 Prot., datë 27.02.2024, protokolluar me tonën me nr.427/3, datë 01.03.2024, autoriteti kontraktor ka paraqitur “*Informacion*” pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe vendimin mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “TRIMED” SHPK, duke vendosur mospranimin e saj.

II.8. Nëpërmjet shkresës me objekt “*Formular i paraqitjes së argumenteve nga operatorë ekonomikë të interesuar*”, protokolluar me tonën me nr.427/4, datë 01.03.2024, nga operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK, në përmbushje të nenit 113, të Ligjit Nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, me anë të së cilës kundërshton ankesën e operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK.

II.9. Nëpërmjet shkresës përcjellë në Sistem, protokolluar me tonën me nr. 427/5, datë 04.03.2024, me objekt “*Formular i paraqitjes së argumenteve nga operatorë ekonomikë të interesuar*” nga operatori ekonomik ankimues “TRIMED” SHPK.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “TRIMED” SHPK me anë të së cilës ngre pretendime për mospërmbushje të kriterëve të përgjithshme për kualifikim nga operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK. Në mënyrë të përmbledhur me argumente si vijon: [...] *Autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë OE nga kjo procedurë prokurimi sepse vjen në kundërshtim të plotë me deklarin që ka bërë ky oe në lidhje me kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit: **pika 1, shkronja a)**, në të cilin thuhet: ofertuesi deklaron se: a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të Posaçem në Rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë ka objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.*

*Pavarësisht se ky OE e ka të deklaruar në objektin e aktivitetit tregtimin e medikamenteve, nuk e përmbush këtë veprimtari vetëdeklarative me dokumentet e nevojshme dhe është duke shtruar veprimtari në shkelje të hapur me ligjin. Pra, shihet qartë, se pavarësisht se AK nuk e ka kërkuar paraqitjen e licencës për tregtimin me shumicë të barnave, kjo e fundit ka për detyrë të kontrollojë informacionet publike dhe të afishuara në faqet zyrtare siç është [ëë.qkb.gov.al](http://ëë.qkb.gov.al), ku publikohen dhe këto të dhëna..[...]*

III.1.1 Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE shtojcën 7, si vijon:

### **KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

*a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

***Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.***

III.1.2 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.3. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të*

*njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.4. Referuar Nenit 82/2 “shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” t VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar:

*2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk duhet të diskriminojë/përjashtojë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar.

Autoriteti kontraktor me kriteret për kualifikim, orienton operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave. Autoriteti Kontraktor harton dokumentacionin e tenderit në përputhje me parimin e proporcionalitetit, i cili bazohet në objektin e prokurimit, llojin e mallrave të kërkuara, fondin limit etj, me qëllim të gjithpërfshirjes në procedurë të operatorëve ekonomikë të biznesit të mesën dhe të vogël si dhe në kuadër të mosdiskriminimit të tyre. Operatorët ekonomikë janë pala e interesur për përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor, publikuar në DST.

Komisioni i Prokurimi Publik thekson, se për sa kohë autoriteti kontraktor përcakton kriteret për kualifikim për procedurën e prokurimit, ato duhet të përmbushen nga operatorët ekonomikë me qëllim që AK të sigurohet, se mallrat e ofruara objekt - prokurimi përmbushin të gjitha parametrat e kërkuara në DST.

III.1.6 Në lidhje me pretendimet e ankimuesit se : [...] *Autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë OE nga kjo procedurë prokurimi sepse vjen në kundërshtim të plotë me deklarin që ka bërë ky oe në lidhje me kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit: pika 1, shkronja a), në të cilin thuhet: ofertuesi deklaron se: a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të Posacem në Rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. [...] Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së operatori ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK në SPE, në përmbushje të kriterëve të përgjithshme për kualifikim, konstatoi, se operatori ekonomik ka ngarkuar dokumentet:*

1. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, ku vëren se me anë të të cilit OE ka deklaruar dhe plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme, për rastet kur të dhënat janë të aksesueshme në mënyrë elektronike nga autoriteti kontraktor, siç parashikohet në dispozitat e në fushën e prokurimit publik.

2. Ekstrakt Historik nga QKB ku vërehet Objekti i Aktivitetit si vijon:

*“Import-Eksport tregtimi me shumice e pakice të medikamenteve dhe të aksesoreve të ndryshëm farmaceutike dhe parafarmaceutike. Tregtim me shumice dhe pakice të lendeve të para dhe produkteve farmaceutike në farmaci, spitale private, shtetërore, laboratore mjekësore dhe klinika të ndryshme mjekësore. Import -Eksport të materialeve për përdorim mjekësor dhe tregtimi dhe furnizimi i tyre në subjekte publike e private. Import-Eksport, tregtimi me pakice e shumice të aparaturave mjekësore, pajisjeve mjekësore dhe pajisjeve ndihmese mjekësore. Hapje klinikash, laboratoresh e farmaci, fizio-terapi etj.. për tregtim medikamentesh dhe materiale parafarmaceutike. Import Eksport ,tregtim me shumice dhe pakice të detergjenteve të llojeve të ndryshëm, pajisjeve të dezinfektimit, solucion dezinfektimi dhe materialeve të pastrimit, higjenes etj Import-Eksport, tregtimi me shumice dhe pakice të materialeve të buta, veshje dhe uniforma spitalore për përdorim të përditshëm. Import-Eksport të materialeve dentare, mobiljeve dhe aksesoreve të mobilerisë, bojrave dhe lendeve të para për to. Import-eksport të tendave të diellit me perberje hekuri, alumini, etj, për bar-restorante dhe cdo institucioni tjetër. Import-eksport të materialeve ndihmese dhe aksesoreve të ndryshëm që kanë lidhje me to. Import eksport të elektro-motorrave dhe pajisjeve elektrike që kanë të bëjnë me to. Tregtim me shumice dhe pakice për keto materiale dhe aksesoreve të*

*tyre. Import -eksport te materialeve elektrike, hidraulike, materialeve te ndertimit, dhe lendeve te para te ndertimit. Import - eksport te materialeve plastike, lendeve te para te prodhimit te plastikes, prodhimeve te tjera farmaceutike. Import-eksport te pajisjeve elektronike, printera, kompjutera, kamera, tonera, dvd, cd etj, instalim dhe projektim i tyre, servis dhe sherbim transporti. Shoqeria po ashtu mund te bashkepunoje me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te ndryshem nga i saj. Dhenie me qira aparatura mjekesore.”*

Komisioni, referuar dokumentacionit të ofertës gjykon, se operatori ekonomik me dokumentacionin e ofertës, ka plotësuar kriteret për kualifikim në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

III.1.7 Për sa i përket pretendimeve të ankimuesit se:

*[...] Pavarësisht se ky OE e ka të deklaruar në objektin e aktivitetit tregtimin e medikamenteve, nuk e përmbush këtë veprimtari vetëdeklarative me dokumentet e nevojshme dhe është duke ushtruar veprimtari në shkelle të hapur me ligjin. Pra, shihet qartë se pavarësisht se AK nuk e ka kërkuar paraqitjen e licencës për tregtimin me shumicë të barnave, kjo e fundit ka për detyrë të kontrollojë informacionet publike dhe të afishuara në faqet zyrtare siç është eëë.qkb.gov.al, ku publikohen dhe këto të dhëna...] Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë Autoriteti Kontraktor nuk ka përcaktuar në Dokumentet e Tenderit një kriter të tillë kualifikues siç ankimuesi, sugjeron dhe pretendon, autoriteti kontraktor nuk mund të kualifikojë apo skualifikojë ofertuesit për një kriter të pa kërkuar.*

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje të operatorit ekonomik, se ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesave mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, parashikuar nga neni 110 pika 1 e LPP. Konkretisht në nenin 110, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Rezulton se ankimuesi është njohur me dokumentet e tenderit në datën e publikimit të njoftimit të kontratës dhe afatet e ankimit për dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi për ankimuesin, nisin nga dita e publikimit të tyre dhe mbarojnë në ditën e shtatë sipas parashikimit ligjor në nenin 110, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Operatori ekonomik është palë e interesuar në përmbushje të të gjitha kërkesave të DST, me qëllim fitimin e kontratës, ndaj ofertimi i mallrave në përputhje me specififikimet teknike dhe kriteret për kualifikim është i rëndësishëm.

KPP thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të



sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

Komisioni gjykon, se bazuar në dokumentacionin e dosjes administrative, është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë operatorët ekonomikë i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “TRIMED” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-93394-01-18-2024, me objekt: “Blerje materiale mjekësore” me fond limit 1,474,160 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Shëndetësore e Specialiteteve nr.1, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapa të mëtejshëm procedurën e prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë derdhjen në buxhetin e shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “TRIMED” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

